



REPUBLIKA E KOSOVËS
IAAP "MITHAT FRASHËRI" GJURAKOC-ISTOG
e_mail : shkolla@mithatfrasheri.org nr.tel.049 766 492; 049 766 655

Gjurakoc,18.10.2022

Nr.pr.19/1

Në bazë të Ligjit për Arsim dhe Afësimin e të rriturve 02/L-64,neni 16 pika 1 dhe Ligjit mbi Arsim në Komunitat e Republikës së Kosovës 03/L-68

IAAP "Mithat Frasheri" në Gjurakoc në bashkëpunim me Drejtorinë Komunale të Arsimit në Istog

SHPALL KONKURS

Për regjistrimin e kandidatëve për arsim për të rritur në klasat X-XI-XII

Regjistrimi bëhet në shkollë në këto drejtime :

- 1.Makineri-----20 vende
- 2.Elektroteknikë -----20 vende
- 3.Hotelieri-----20 vende
- 4.Ndërtimtari-----20 vende

Kushtet e konkursit:

- 1.Regjistrimi vijues në programin "Arsimi për të rritur ",bëhet sipas procedurave të njejtta të regjistrimit për nxënësit e rregullt ,siç është paraparë në nenin 10.2 pikat q,b dhe nenit 17.3 të Ligjit mbi Arsimin fillor dhe të mesëm në Kosovë.
- 2.Në programin "Arsimi për të rritur " në IAAP vijuesve iu mundësohet që një vit të plotë shkollor ta përfundojnë në afat prej 18javësh të mësimi (UA-Nr.11/2011)
- 3.Të drejtë regjistrimi kanë të gjithë të interesuarit të cilët kanë kaluar moshën 18vj.

Dokumentet e nevojshme për regjistrim :

1.Deftesa e klasave të kryera ,

2.Certifikata e lindjes

Pagesa

Shkollimi në nivelin e arsimit të mesëm të lartë është me pagesë.Participimi bëhet në bazë të udhëzimit administrative,MASHT nr.30/2011.

Pagesa bëhet në xhirrollogarinë komunale të participimit për arsim(parapakisht në shkollë merret Unirefi).

Pagesa vijuese për vijimin dhe për përfundimin e arsimit dhe aftësimin për të rritur në IAAP do të jetë:

- 1.Për regjistrimin e vitit për në klasë 100 euro
- 2.Praktika profesionale 50 euro
- 3.Për dhënien e provimeve diferenciale apo plotësuese 10 euro
- 4.Për provimin përfundimtar të klasës ,certifikatë 30 euro
- 5.Për diplomë të përfundimit të shkollimit 50 euro.

Pagesa bëhet në xhirrollogarinë përkatëse të institucionit përmes bankës.

Vijuesit të cilët ndërrojnë profilet do të ju nënshtrohen provimeve diferenciale bazuar bazuar në UA-30/2011.

Kandidatët të cilët ndërrojnë drejtimin janë të obliguar që parapakisht të ju nënshtrohen provimeve plotësuese diferenciale .

Dhënja e provimeve plotësuese dhe diferenciale bëhet në afat të veçantë nga vijimi I klasës për të cilën kandidati është paraqitur për regjistrim.Diplomat të cilat merren në programin "Arsimi dhe Aftësimi për të rritur"janë të barasvlefshme me diplomat e mësimin të rregullt.

Konkursi është I hapur 15 ditë ,nga dita e publikimit në mjetet e informimit.



Drejtoresha

Drita Ferati